Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Majlinda Bedrolli ***Ekspert shqyrtues***	***Data e autorizimit të ekspertit*** ***28.03.2022***	***Data e dorëzimit të raportit*** ***07.04.2022***	***Nr. i lëndës:*** ***74/22***

1.BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën:25.03.2022, OE ankues **"SB Construction"shpk -Obiliq**, ka parashtruar ankesë me nr: **74/22,** kundër propozimit për dhënie të kontratës, ku është rekomanduar për kontratë grupi i operatorve ekonomik **"Graphite Architecture" shpk – Vushtrri,** lidhur me aktivitetin e prokurimit: ***"Furnizim me gëlqere të hidratizuar për Flotacionin në Tunel i Parë",*** me nr.të prokurimit**:** 12997 12998-22-529-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Trepça SH.A. –Mitrovicë.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë – furnizim me një operator ekonomik, vlera e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët, vlera e parashikuar e kontratës: 80 080,00€

Data e njoftimit për kontratë 04/02/2022, Afati i fundit i dorëzimit të tenderit 25.02.2022, Njoftimi per vendimin e AK-së, 08.03.2022, kërkesa për rishqyrtim 14.03.2022, shkresa emali përgjigjja nga AK ndaj kërkesës për rishqyrtim e datës 15.03.2022.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

2. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankus pretendon se AK, nuk i ka respektuar dispozitat e LPP-së, sic janë

Neni 1, 5, 7, 59, 60 dhe 69 të LPP-së.

DEKLARATA DETALE E ANKESES

Së pari po ju sqarojmë se Autoriteti Kontraktues ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim për arsye se është bërë jashtë afatit ligjor. Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues është e datës 08.03.2022

Dokumenti shtojca

Versionl i tanishëm: 08.03.2022 13:21 B58 HJOFTIM PER VEHDIMIII E AK.pdf

Versionet

ITape: Shqip *f*

Ne si OE kemi bërë Kërkesën për Rishqyrtim me datë 14.03.2022 ora 12:42.

Data e dërgimit të kërkesës

14.03.2022 12:42

Autoriteti Kontraktues ka dërguar E-mail ‘’Përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim” në të cilën ka theksuar se kërkesa për rishqyrtim është bërë jashta afatit 5 ditorë.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur Nenin 5 të Ligjit mbi Prokurimin Publik në të cilin nen tregon se si kalkulohet afati.

Neni 5
Kalkulimi i afateve kohore

1. Afatet kohore të këtij ligji duhet të fillojnë në një ditë pune dhe të përfundojnë në një ditë pune. Afati kohor i shkon deri në 16:00 në ditën e skadimit. Autoriteti kontraktues mund të vendosë që të caktojë një kohë tjetër me kusht që ai është jo më herët se në ora 12:00 të ditës së skadimit.

2. Të shtunave, të dielave dhe festave zyrtare do të llogariten gjatë kalkulimit të afateve kohore. Megjithatë, kur dita e fundit e afatit bie në një të shtunë, një të diel ose në një festë zyrtare afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj.

Ne kemi paraqitur Kërkesën për Rishqyrtim brenda afatit ligjor. Në këtë rast dita e fundit për paraqitjen e

kërkesës për rishqyrtim pas Njoftimit mbi Vendimin e AK ka qenë dita e diel dhe sipas pikës 2 të nenit 5 të LPP-së nëse dita e fundit e afatit bie në një të shtune, një të diele, afati kohor do të zgjatet për të përfshirë ditën e parë të punës pas kësaj. Afati kohor duhet të fillojë një ditë pune dhe të përfundojë një ditë pune.

Kjo është e sqaruar edhe tek pyetjet e shpeshta ne web faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik përkatësisht në pyetjen e 70-të.

Në kërkesën për rishqyrtim kemi paraqitur këto pretendimi:

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues Trepça SH.A gjatë procesit të vlerësimit të ofertave për këtë aktivitet të prokurimit ka eliminuar SB Construction SHPK në të cilën ka vepruar në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës, Ligji Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të Nenit 59 të LPP-së për arsye se Autoriteti Kontraktues shpërblen me kontratë OE ‘’Graphitc Architecture” SHPK me adresë në Vushtrri, në të cilën ka paraqitur një ofertë apo tender që nuk është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit dhe që ka ardhur në kundërshtim me automatizëm të nenit 1 të LPP-së që ka të bëjë me sigurimin në mënyrë më efikase, më transparente të shfrytëzimit të fondeve publike dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që burojnë nga ky ligj.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar OE në mënyrë të barabartë specifikisht në përmbushjen e kushteve sipas dosjes së tenderit që është në kundërshtim të plotë të nenit 7 të LPP-së. Dosja e Tenderit nga dy Operatorët Ekonomik “Graphite Architecture” SHPK dhe N.P.T. ‘’a-com’’ nuk është përmbushur dhe se OE kanë dorëzuar oferta të papërgjegjshme e cila është në kundërshtim të nenit 60 të LPP-së.

Sipas FTD-së është kërkuar Certifikata e Kualitetit ‘’Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015 mirëpo OE “Graphite Architecture” SHPK i rekomanduar për kontratë në formularin e tenderit të dorëzuar nuk ka dorëzuar asnjë certifikate të tillë me rastin e dorëzimit të ofertës por ka dorëzuar disa fotografi të gëlqeres WES LIME DOO dhe një katalog të gëlqeres të një prodhuesi tjetër, pra nuk ka dorëzuar certifikatën e kërkuar e cila është në kundërshtim të plotë me nenin 69 që ka të bëjë me aftësitë teknike.

Sipas dokumenteve që kemi marrë nga Autoriteti Kontraktues duke u bazuar në kërkesën për qasje në dokumente, gjindet një certifikatë nga një prodhues tjetër si dhe nuk është dorëzuar me rastin e ofertës dhe nuk dihet se si është dorëzuar ky dokument, a janë kërkuar informata sqaruese apo jo. Edhe pse është dorëzuar kjo certifikate prap nuk i përmbush kushtet e dosjes së tenderit, sepse është pa afat dhe se afati i kësaj certifikatë ka skaduar më 17.03.2021.

Ofertuesi tjetër N.P.T. ‘’a-com’’ nuk është i përgjegjshëm pasi që tek paramasa e dorëzuar ka ndryshuar sasinë si dhe njësinë, pra ka bërë ndërhyrje në paramasën e paraqitur nga Autoriteti Kontraktues. Që të dy OE kanë ofertuar ofertat e tyre të pa përgjegjshme dhe se Autoriteti Kontraktues ka bërë shkeljen e Ligjit të Prokurimit Publik të R. së Kosovës.

Sa i përket arsyetimit për eleminimin tonë nga AK nuk qëndron, pasi që gëlqerja në rastin kur është bërë pranimi ajo nënkupton se plotëson kërkesat sipas specifikimeve teknike në të kundërtën nuk duhej pranuar. Po ashtu për këtë është dashur të njoftohemi para datës së dorëzimit të ofertave e jo gjatë fazës së vlerësimit të dorëzohen këto raporte. Pra ne si ofertues i plotësojmë të gjitha kriteret e vendosura në FTD dhe jemi ofertues i përgjegjshëm.

Andaj duke ju referuar argumenteve dhe fakteve të paraqitura më lartë, shkeljet e dispozitave të LPP-së nga AK dhe duke parë se OE SB CONSTRUCTION SHPK ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët kërkojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar, lënda të kthehet në rivlerësim dhe të rekomandohemi për kontratë pasi që jemi OE i përgjegjshëm me çmimin më të ulët.

3. FAKTET E RASTIT TË RËNDËSISHME PËR PRETENDIMET

			Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), të Ligjit Nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin Nr. 05 L-092. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov.net. 2. Operatori ekonomik duhet të dorëzoj dëshmi lidhur me nenin 65, paragrafi 3, nen-paragrafi 3.1, 3.3, 3.4, 3.5 dhe 3.6 dhe paragrafi 4, nen-paragrafi 4.1, 4.2, dhe 4.4]. 3. Operatorit ekonomik duhet të deshmon se nuk**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar dhe vulosur nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar në dosjen e tenderit Aneksi 2 - kërkohet të dorzohet nga çdo ofertues me rastin e dorzimit të ofertës-tenderit të tij. 2. Vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit-duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para Njoftimit te Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet]. 3. Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore- duhet të dorëzohet nga tenderuesi fitues para Njoftimit**

			është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. [Neni 65 paragrafi 4, nënparagrafi 4.8].	**të Tenderuesve, respektivisht dorëzimit te letrave standarde. [Në rast të dështimit të dorëzimit tenderi në fjalë do të refuzohet].**
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale		7.1 & 7.2	**Përshtatshmëria profesionale** **1. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e vet të themelimit. 2. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për TVSH. 3. Operatori ekonomik duhet të dëshmoj regjistrimin për numrin fiskal.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Kopje e certifikatës të biznesit.** **2. Kopje e certifikatës për TVSH.** **3. Kopje e regjistrimit të numrit fiskal.**
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare		8.1 & 8.2	**Kapaciteti ekonomik dhe financiar**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale		9.1 & 9.2	**Kapaciteti teknik dhe professional** **1. Duhet të dëshmojë Certefikata e kualitetit përkatëse valide.**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Certifikata (Certifikimi i prodhuesit sipas ISO 9001 2015).**

4. RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Duke u bazuar në B58 Njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues të datës 08.03.2022, është konstatuar si në vijim: AK-Trepça SH.A. –Mitrovicë, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik "Graphite Architecture" shpk – Vushtrri, në vlerë totale prej 71,390.00 euro.

5. VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

6. ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

NA

7. VLERËSIMI I PRETENDIMEVE TË NDRYSHME TË ANKESËS

Sqarim hyrës: Autoriteti kontraktues Trepça SH.A. –Mitrovicë, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontratë publike kornizë – furnizim me një operator ekonomik, vlerë e mesme, kriteri i dhënjes së kontratës tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër propozimit për dhënie të kontratës dhe eliminimit të ofertës të OE ankues.

Sqarojmë se neni 111 i LPP-së, përkatësisht paragrafi 5 i këtij nenin ka përcaktuar:

5. *"Nëse OSHP konstaton se ankesa është parashtruar me kohë dhe i plotëson kushtet sipas paragrafit 1. të këtij neni OSHP menjëherë do të (i) caktojë një ekspert për shqyrtim sipas nenit 113 dhe (ii) formojë një panel shqyrtues për t'i shqyrtuar pretendimet e bëra në ankesë".*

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) "SB Construction"shpk -Obiliq

Pas administrimit dhe shqyrtimit të shkresave të lendes në platformën e-prokurimit, letrës standarde për tenderuesit e eliminuar të datës 08.03.2022, përkatësisht kërkesës për ri shqyrtim dhe përgjigjes se AK-se shkresës të bashkangjitur në ankesë të datës 15.03.2020, rezulton qe AK – Trepca sha, nuk i ka aplikuar detyrimet e dala me dispozitat e nenit 108/A, të LPP-se:

1. Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj, siç parashikohet me këtë ligj, janë shkelur nga vendimi i një autoriteti kontraktues gjatë kryerjes së një aktiviteti të prokurimit dhe i cili është dëmtuar apo rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar, mund të paraqesë një kërkesë për rishqyrtim pranë atij autoriteti kontraktues. ***Kërkesat për rishqyrtim mund të ndërlidhen me njoftimet për kontratë,*** *dokumentet e tenderit, ose njoftimet dhe vendimet tjera siç përcaktohet në këtë ligj, gjatë kryerjes së aktivitetit përkatës të prokurimit.*

2. Dorëzimi i një kërkese për shqyrtim e obligon autoritetin përkatës kontraktues që automatikisht të pezulloj zbatimin e aktivitetit të prokurimit me të cilin ka të bëjë shkelja e pretenduar.

3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

3.1 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave;

3.2 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.

3.3 në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda pesë (5) ditëve nga data kur aktiviteti I prokurimit është anuluar zyrtarisht përmes njoftimit për anulim.

4. Aplikimet për rishqyrtim duhet të paraqiten me shkrim dhe duhet të përmbajnë të njëjtin informacion dhe dokumente të përcaktuara në nenin 111 paragrafi 1 të këtij ligji, me përjashtim të nën-paragrafit 1.9 dhe 1.10.

5. Nëse aplikimi nuk përmban disa nga informacionet referuar në paragrafin 4 të këtij neni, autoriteti kontraktues do të kërkojë nga ankuesi që të plotësoj kërkesën e tij Brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i ankesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishikim do të refuzohen si e paplotë.

6. Autoriteti kontraktues do ta shqyrtojë kërkesën brenda tre (3) ditë pune nga data e dorëzimit të aplikimit ose, kur është e zbatueshme, nga data e marrjes së informative shtesë dhe dokumenteve të parashikuara në paragrafin 5 të këtij neni. Afati i përmendur më lart, në raste specifike të justifikuara mund të zgjatet për jo më shumë se tre (3) ditë shtesë, dhe ankuesi do të informohet për këtë.

7. Kundër vendimit të autoritetit kontraktues, ankuesi mund të paraqesë një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

8. *Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:*

8.1. kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni;

8.2. ankesa nuk është paraqitur kundër një njoftimi ose vendimi siç referohet në paragrafin 1 të këtij neni;

8.3. ankesa nuk përputhet me kërkesat e përmendura në paragrafin 4 dhe 5 të këtij neni;

8.4. autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi.

9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim.

10. Autoriteti kontraktues mund, me anë të një vendimi:

10.1. të refuzojë kërkesën e propozuar për shqyrtim si të pabaza;

10.2. të miratojë një kërkesë për rishikim si të bazuar dhe të anulojë pjesërisht ose tërësisht vendimin e miratuar;

11. Vendimet e parashikuara në këtë pjesë ***janë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese*** *dhe duhet të zbatohen menjëherë.*

12. Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë.

13. Pavarësisht nga paragrafi 3 i këtij neni, miratimi i një refuzimi apo vendimi në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni përfshin pezullimin e menjëhershëm të masave të miratuara sipas paragrafit 2 të këtij neni.

14. Kundër refuzimeve të miratuara sipas nën-paragrafëve 1, 2 dhe 3 të paragrafit 8 dhe vendimeve të marra sipas nën-paragrafëve 1 dhe 2 të paragrafit 10 të këtij neni, ankuesi ose ndonjë palë e interesuar, nëse ka, mund të paraqesë, në çdo rast, një ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109.

Për me teper, edhe *F03 "Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteve Kontraktuese, parashtrim te ankesave pranë OSHP dhe vlera e tarifave te ankesave"* përcaktojnë këtë situatë. Andaj propozimi ynë për AK-ne është qe lenden ta kthej ne **ri shqyrtim** dhe ti aplikoi dispozitat ligjore të LPP-së.

Provë: bashkangjitur me raport gjeni kopje :

Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar

Njoftimin mbi vendimin e AK-së

Kërkesën për rishqyrtim të datës 14.03.2022 dhe dëshmia në platformën e-prokurimit

Përgjigjja ndaj kërkesë për rishqyrtim emalin i datës 15.03.2022

8. MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, dhe të obligohet AK- Trepça SH.A. –Mitrovicë, që lëndën ta kthej në **ri shqyrtim** dhe ti trajtoj pretendimet ankimore siç parashifen me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - Trepça SH.A. –Mitrovicë
- Panelit Shqyrtues - OSHP.
- OE ankues - "SB Construction"shpk -Obiliq